



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1421 Prot.

Tiranë, më 12 / 03 /2020

URDHËR

Nr. 165, datë 12.03.2020

PËR MBYLLJEN E KABINETEVE/KLINIKAVE DENTARE

Në zbatim të nenit 7, pika 4 të ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, Ligjit nr 9106 datë 17.07.2003 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë” me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e kabineteve/klinikave dentare, në të gjithë vendin deri në datën 3.04.2020.
2. Rastet e urgjencave stomatologjike të trajtohen në Klinikës Stomatologjike Universitare pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe në institucionet stomatologjike publike që do të funksionojnë vetëm për shërbimin e urgjencës stomatologjike.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri.
4. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e Urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

